



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Up1 Nr.03-120
15.04.2022
Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 2 nga po i njëjti Ligj, pika 4 i Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/5 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi si në vijim:

Vendim
për marrjen masë – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) Televizion SITEL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 53 paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor televiziv të radiodifuzerit, i transmetuar më datat 21, 22 dhe 23 shkurt 2022, në pjesë të emisioneve të mëngjesit, emisionit informativ-argëtues ”E dua Maqedoninë“, të transmetuara janë fshehur komunikime komerciale audiovizuele të produkteve „Prostatol kompleks“ dhe „Bronho protekt“ nga operatori ushqimor „Natura terapi“.

Shkelja e paragrafit 1 e kësaj pike, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022 , e cila është pjesë përbërse e Vendimit si Shtojcë nr.1.

2.DETYROHET SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup menjëherë pas pranimin të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në mbikëqyrje, i paraqitur në pikën 1 i këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit llogaritet dita e verifikimit në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjenci) bazuar në nenin 28 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), është kompetent të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe dhënësve të shërbimeve audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i ritransmeton operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akteve të tjera të sjella nga vetë Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmorri masë –vendim për vërejtje publike në pajtueshmëri me Ligjin, në raste të shkeljes së dispozitave

nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Neni 53 paragrafi 2 nga LSHMAAV parasheh se nuk lejohen komunikime komerciale audiovizuale të fshehura.

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 22 mars 2022, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) ndaj shërbimit programor televiziv SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup, transmetuar më datat 21, 22 dhe 23 shkurt 2022, në nivel shtetëror, ku konstatoi shkelje të nenit 53 paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale – ndalesë për komunikime komerciale audiovizuale të fshehura. Mbikëqyeje e jashtëzakonshme ishte realizuar pas njoftimit nga Agjencia për ushqim dhe veterinari për vepra komunikimi komerciale audiovizuale të paligjshme për shtesa ushqimore, dhe në kuadër të Memorandumit për bashkëpunim midis Agjencisë dhe AUV, lidhur më 14.04.2021.

Shkelja u konstatua në emisionin e mëngjesit, emision informativ-argëtues „E dua Maqedoninë“, përmes bisedave me Sashko Drvoshanskin, nutricionist –menaxher kryesor për kujdesin ndaj shfrytëzuesit, edukim dhe zhvillim të produkteve nga operatori ushqimor „Natura terapi“ („Natura therapy“), të regjistruara si dy shtojca të veçanta, të bëra si prezantime komerciale vizuale dhe verbale të cilat janë veçanërisht promovuese dhe rekomandohen „Prostatol kompleks“ („Prostatol complex“) dhe „Bronho protekt“ („Broncho protect“). Pra, në emisionin „E dua Maqedoninë“, të fshehura si përmbajtje mediatike kushtuar shëndetit, me dy premiera dhe një emision reprizë, më datat 21, 22 dhe 23 shkurt 2022 ku vizualisht dhe verbalisht janë prezantuar shtesat ushqimore „Prostatol kompleks“ dhe „Bronho protekt“, me qëllim reklamues dhe mund të paraqesë tek publiku përgënjeshttrim për natyrën e përmbajtjes, dmth transmetohen komunikime komerciale audiovizuale të fshehura.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022, e cila është pjesë përbërse e Vendimit si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup më 24.03.2022, dërgoi shkresë – Paraqitje e Raportit me shkrim nga mbikëqyrja për shpjegim ark.nr.10-1163/2 nga 24.03.2022, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022, ku në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkelje të dispozitave nga LSHMAAV. Në afatin e paraparë, SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup nuk arsyetoi shkeljen e dispozitave nga Ligji. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022, e shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup të shqiptohet masë-vërejtje publike.

Duke u bazuar në paraqitjen e mësipërme, të nenit 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit, pika 4 e Udhëzuesit për përcaktim të afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastuar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/5 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e mbajtur më 15.04.2022, për konstatim të shkeljes së dispozitave nga LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi, miratoi Vendim për paralajmërim publik ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup dhe detyrohet menjëherë pas pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe ndaj tij radiodifuzeri mund të ngrejë padi për kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ duhet të paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa më lartë u paraqit, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontest administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojca (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1163/1 nga 23.03.2022.

Dorëzuar tek:

- SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup;
- Administratorit të SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup;
- Personit përgjegjës të programit në SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup;
- Sektorit për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektorit për çështje programore;dhe
- Personave të autorizuar në Agjencion për udhëheqjen e regjistrit Up1.